



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:235555  
Datë: 28.01.2025  
Numri i dokumentit: 06767932

Ac.nr.4947/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Besnik Feka-anëtarë, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditëses B.K.S, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.L, kundër të paditurit B.Z nga fshati ....., komuna e Mitrovicës, me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme av.F.B nga Vushtrria, me objekt kontesti rimbursimit e dëmit, me vlerë të objektit të kontestit në shumë prej 1365 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, C.nr.442/2015, i datës 06.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.01.2025, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e përfaqësueses së përkohshme të të paditurit B.Z, av.F.B nga Vushtrria, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni C.nr.442/2015, i datës 06.04.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri-Departamenti i përgjithshëm Divizioni civil C.nr.442/2015, i datës 06.04.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.442/2015, i datës 06.04.2023 ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.K.S, me seli në Prishtinë, dhe DETYROHET i padituri B.Z, nga fshati ....., komuna Mitrovicë, që paditëses t'ia paguaj shumë prej 1365.00€ (njëmijë e trqindë e gjashtëdhjetë e pesë euro), në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 03.10.2012, në ora 00:00 minuta, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. II. DETYROHET i padituri B.Z, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për shpenzimet e krijuara për përfaqësues të përkohshëm, shumë prej 374.00 euro, për ekspertizë, shumë prej 150.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi, shumë prej 20.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit , për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ,aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194,195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e përfaqësueses së përkohshme të të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi kundër të paditurit për rimbursim dëmi me datën 24.11.2015 si pasojë e aksidentit të datës 03.10.2012.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim mes tjerash ka theksuar: Gjykata në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së, ka administruar provat si, skica e vendit të aksidentit e datës 03.10.2012, dosjen e dëmit me numër 1727/12, transferin bankar të datës 17.12.2012, urdhër transferin e datës 23.11.2012, ujdinë jashtë gjyqësore të datës 23.11.2012, kalkulimin e dëmit dhe akt vlerësimin e tij, të dyja të datës 22.11.2012, polisën e sigurimit të datës 05.01.2011, faturën për bartjen e automjetit të datës 03.10.2012, raportin e aksidentit me numër ..., të datës 03.10.2012, vendimin e paditëses të datës 02.12.2012, është vështruar foto-dokumentacioni nga 1 deri në 3 foto, përgjigja në padi e datës 07.10.2023, ekspertiza e komunikacionit e datës 10.02.2023. Nuk është kontestues fakti se i padituri më 03.10.2012 në ora 00:00, me automjetin G..., me targa të regjistrimit ..., ka qenë pjesëmarrës i aksidentit, në të cilin aksident ka qenë i përfshir edhe automjeti O.A me targa ....., të cilin e drejtonte D.M. Gjithashtu, nuk ishte kontestuese se automjeti G., me targa të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte i padituri, nuk ka qenë i siguruar për të cilën nga polisa e sigurimit e datës 05.01.2011, konstatohet se automjeti me targa të regjistrimit ..., me të cilin është shkaktuar aksidenti i ka skaduar sigurimi me datë 06.01.2011. Nuk ishte kontestuese se nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 23.11.2012, konstatohet se paditësja B.K.S ka lidhur ujdi jashtëgjyqësore me D.M, për ti kompensuar dëmin në shumë prej 1365.00 euro, të cilën shumë i'a ka kompensuar të njëjtit, e që konstatohet nga urdhër transferi i datës 23.11.2012. Kontestuese ishte se me lëshimet e kujt ka ardhur deri te aksidenti i datës 03.10.2012, por këtë fakt gjykata e vërtetoj nga ekspertiza e komunikacionit e datës 10.02.2023, dhe konstatoj se deri te aksidenti i datës 03.10.2012, në rrugën Prishtinë Mitrovicë, në dalje të qytetit të Vushtrrisë, te K.P, ka ardhur kur ngasësi i automjetit A. V.W. G. ka qenë duke lëvizur nga drejtimi i Prishtinës, me të arritur në dalje të qytetit të Vushtrrisë, , në udhëkryqin te “KP” ,me saktësi te depoja “F”, si pasojë e pa kujdesisë humb kontrollin mbi automjeti, del në shiritin e drejtimit të kundër, e me pjesën e parë ballore në pjesën e parë ballore të automjetit e godet automjetin B, kështu që shkaktar i aksidentit është vozitësi i automjetit A, V.W G..., të cilin e ngiste i padituri B.Z. Meqenëse gjykata vërtetoj se aksidenti i komunikacionit të datës 03.10.2012, ka ardhur me fajin e të paditurit dhe se në momenti ne aksidentit, automjeti të cilin e drejtonte i padituri, nuk posedonte mbulesë të sigurimit, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, dhe atë duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ku parashihet se “*Personi i dëmtuar të cilin i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*”. Po ashtu, gjykata vlerëson se e drejta për regres paditëses, i takon edhe në bazë të paragrafit 3 të të njëjtit nen “*Siguruesi pas përmbushjes së*

detyrimin nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguroese.”, ku në këtë procedurë kontestimore, u vërtetua fakti se paditësja e kishte përmbushur detyrimin ndaj palëve të treta, të cilës i padituri iu kishte shkaktuar dëm material. Në nenin 357 par.1 të LMD-së, përcaktohet se “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”. Andaj nuk qëndron pretendimi i përfaqësueses së përkohshme të të paditurit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, pasi që rastin konkret afati i parashkrimit llogaritet nga dita kur paditësja ka bërë kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, të cilin kompensim e ka bërë ndaj të dëmtuarit D.M, e që konstatohet nga urdhër transferi i datës 23.11.2012 dhe nga transferi bankar i datës 17.12.2012, ndërsa padinë e ka parashtruar pranë kësaj gjykate me datë 24.11.2015, brenda afatit ligjor. Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën ligjore, gjykata vendosi konform nenit 382 të LMD-së, nga dita e parashkrimit të padisë 01.12.2015, e deri në pagesën definitive të detyrimit. Gjykata, për shpenzimet e procedurës, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, konform nenin 452 par. 1 të LPK-së, ashtu që obligoj të paditurit si palë e cila e ka humbur kontestit, që t’ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës, dhe atë për shpenzimet e krijuara për përfaqësues të përkohshëm, shumën prej 374.00 euro, për ekspertizën e komunikacionit, shumën prej 150.00 euro, si dhe për taksën gjyqësore për padi, shumën prej 20.00 euro. Andaj, bazuar në të lartcekurat e në pajtim me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as me shkelje të tjera të pretenduara nga përfaqësuesja e përkohshme e të paditurit, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore për parashkrim të borxhit, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë drejt dhe ligjshëm ka vendosur lidhur me pretendimin për parashkrim të dëmit, për shkak se në rastin konkret afati i parashkrimit llogaritet nga dita kur paditësja ka bërë kompensimin e dëmit palës së dëmtuar, të cilin kompensim e ka bërë ndaj të dëmtuarit D.M e që konstatohet nga urdhër transferi bankar i datës 17.12.2012 ndërsa padinë e ka parashtruar në gjykatë me datë 24.11.2015, e sipas kësaj pretendimi ankimor për parashkrim të kërkesës është i pabazuar.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:235555  
Datë: 28.01.2025  
Numri i dokumentit: 06767932

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4947/2023, me datë 28.01.2025.

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari  
Fatmir Baloku d.v